



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 100 Prot.

Tiranë, 25/08 2023

Lënda: Kërkesë për informacion në lidhje me kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Drejtuar: Z. Dorian TOLA
Drejtor i Përgjithshëm
Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar

Tiranë

I nderuar z. Tola!

Së pari shpreh konsideratën më të lartë të bashkëpunimit të deritanishëm. Më tej më, lejoni t'ju informoj se Avokati i Popullit në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është duke zhvilluar procedurat që lidhen me verifikimin paraprak nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc të plotësimit të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale dhe morale dhe renditjen e kandidatëve që kandidojnë për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e Avokatisë.

Ndër kompetencat specifike që i ngarkohen Avokatit të Popullit në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc janë edhe kompetencat e renditura në pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 31, si dhe në pikën 2, 3, 4, të nenit 129 të ligjit të sipërcituar.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 31 dhe pikës 3 të nenit 129, ku përcaktohet se: "*Për kontrollin e kushteve të tjera ligjore, kryetari i Komisionit dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës*", del e nevojshme që të verifikohet pranë institucionit tuaj përmbushja e kriterit ligjor, të përcaktuar në germën ç, pika 3, të nenit 21 dhe germën g, pika 3, të nenit 119.

Në këto dispozita citohet se: "Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

- *Që nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës.*

Për plotësimin e këtij kushti lind nevoja e verifikimit të tij në institucionet përgjegjëse.

Mbi bazën e listës së emrave të kandidatëve që kanë aplikuar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilat po i dërgojmë bashkëngjitur kësaj shkrese, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon bashkëpunimin tuaj për verifikimin sa më të shpejtë të kandidaturave përkatëse dhe konfirmimin nëse në bazë të të dhënave tuaja se cilët kandidatë nëse plotësojnë kushtin e mësipërm ligjor.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca

